



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 882 Prot.

Tiranë, më 06.07 2018

VENDIM Nr. 118, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturorë" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania "MUHURRI 1590" Dibër- subjekti "TELEKOM ALBANIA" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania "MUHURRI 1590" Dibër-subjekti "TELEKOM ALBANIA" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "TELEKOM ALBANIA" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania "MUHURRI 1590" Dibër, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al